



## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS ME RASTIN E DITËS BOTËRORE KUNDËR PUNËS SË FËMIJËVE**

*12 Qershor 2018*

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e vlerëson maksimalisht nismën e Avokatit të Popullit për trajtimin e çështjes mjaft të ndjeshme të punës së fëmijëve, si edhe për organizimin e këtij takimi me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve vendore që kanë përgjegjësinë për t'u marrë me këtë çështje. Gjithashtu e vlerësoj praninë e Zëvendësministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Deputetes së Kuvendit të Shqipërisë dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që kanë ardhur sot nga Tirana sikurse edhe ne.

Nga raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2015, u informuam se 200 fëmijë punojnë në sektorin e energjisë, shumica e tyre në Bulqizë. Kjo nuk është një gjë që i përket së kaluarës. Sot në mëngjes ne u ngjitëm te stoqet e kromit dhe takuam disa fëmijë të vegjël, njëri prej të cilëve na tregoi se shumica e shokëve të tij punojnë në atë vend. Kjo është një situatë e trishtueshme dhe e papranueshme. Nëse i gjithë sistemi dhe e gjithë shoqëria nuk arrin t'i mbrojtë fëmijët nga punët e rrezikshme dhe puna e fëmijëve, atëherë kjo tregon se ata janë edhe më të cenueshëm ndaj formave më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut, si trafikimi, shfrytëzimi dhe emigrimi i paligjshëm i fëmijëve.

Jemi të vetëdijshëm për faktin se ekzistojnë mekanizmat ligjorë, si për mbrojtjen e fëmijëve, ashtu edhe për antitrafikimin. Ne jemi duke mbështetur institucionet qendrore dhe vendore të forcojnë mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve me qëllim parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe fenomeneve të tjera të ngjashme si shfrytëzimin seksual, emigrimi i paligjshëm, e kështu me radhë. Ekziston një përpjekje e përqendruar e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, UNICEF-it, OSBE-së dhe organizatave të rëndësishme që merren me mbrojtjen e fëmijëve, për krijimin e procedurave të reja për mbrojtjen e fëmijëve, të cilat përfshijnë procedura për evidentimin e fëmijëve që shfrytëzohen ekonomikisht si dhe procedura për parandalimin e trafikimit të fëmijëve. Sidoqoftë, këto procedura rrezikojnë të mbeten letra në sirtar, nëse mungon vullneti politik dhe personal për të theksuar nevojën urgjente për eliminimin e punës së fëmijëve. Shqipëria u angazhua në vitin 2017 në një përpjekje të suksesshme për ndalimin e prodhimit të kanabisit, përpjekje e cila po vazhdon edhe sivjet. Uroj që një përpjekje e ngjashme të bëhet edhe për një mbrojtje më të mirë të fëmijëve. Fëmijët janë pjesa më e dobët e shoqërisë. Më lejoni të theksoj disa pika kyçe:

- Strukturat për mbrojtjen e fëmijëve kanë nevojë urgjente për financim. Pres të dëgjoj nga diskutimet e sotme se cilat janë planet dhe fondet në dispozicion të Bashkisë së këtushme për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi. Jeni të bekuar me burime natyrore, nga të cilat qeveria vendore duhet të përfitojë.

- Si është situata e pjesës së rentës minerare që duhet t'i akordohet qeverisë vendore? A mund të përdoret për të trajtuar problematikën e familjeve me të ardhura të ulëta, të cilat nuk shohin mundësi tjetër përveç se të bazohen në punën e fëmijëve?

- Së treti, duhet të theksoj kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziku, nuk duhet të ketë asnjë shfaqësish përgjegjësish institucionale për mosmarrjen e masave të menjëhershme për largimin e fëmijëve nga puna e rrezikshme dhe për trajtimin e secilit rast në mënyrë

specifike, ashtu sikundër tha edhe kolegu im i UNICEF-it. E kuptoj që fenomeni është i ndërlikuar dhe që për trajtimin e tij një sërë institucionesh duhet të punojnë së bashku. Legjislacioni i ri kërkon që të punoni së bashku, si një ekip shumëdisiplinor, për të gjetur zgjidhje dhe për ta shëruar këtë plagë.

- Jemi këtu edhe për të dëgjuar shqetësimet tuaja dhe për të shqyrtuar mënyrat se si mund t'ju ndihmojmë. Prezenca e OSBE-së është e gatshme t'ju ndihmojë për zhvillimin e instrumenteve të nivelit vendor që pasqyrojnë situatën e posaçme vendore, duke mbështetur njëkohësisht rritjen e kapaciteteve institucionale për të përdorur qasje që bazohen te të drejtat e njeriut për trajtimin e situatës së fëmijëve dhe për të parandaluar shkeljet e rënda.

Ne të rriturit e kemi për detyrë të rritim një brez të sigurt dhe të shëndetshëm.

Shumë faleminderit për vëmendjen!